

VENDIM
Nr. 471, datë 31.7.2018

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË NJË ANËTARI TË KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT
E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE
TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin e znj. Silvana Simaku në detyrën e anëtarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama